



ISMET KRYEZIU: KJO KLASË POLITIKE NUK KA AS KAPACITET E AS PËRGJEGJËSI PËR T'I NDËRTUAR DHE FUNKSIONALIZUAR INSTITUCIONET

FAQE 4-5



Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se moshirrrja e seancës konstituive të Kuvendit dhe arsyetimi i

presidentes në detyrë, Albulena Haxhiu, se partive politike duhet t'u lihet edhe më shumë kohë për negociata, është sa qesharak, aq

edhe i papërgjegjshëm ndaj qytetarëve. Ai thotë se kërkesa për një president "jopartiak" synon një figurë të nënshtruar ndaj pushtetit

ÇFARË MUND TA NDALE GJUHËN E ASHPËR TË SERBISË KARSHI KOSOVËS?

F. 5



ABDIXHIKU: PAS NISMËS PËR SHKARKIMIN TIM, NDËRPRES ANGAZHIMIN PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE

F. 7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



KOS SHPREH HABI QË PAUNOVIO VAZHDON TË JETË MINISTRE F. 2

VESELI DHE KRASNIQI MBETEN NË PARABURGIM, GJYKATA UA REFUZON KËRKESAT PËR LIRIM TË PËRKOHSHËM F. 3

SENATI FORMON KOMISIONIN PËR STANDARDIZIMIN E DOKUMENTEVE DHE MATERIALEVE PROMOVUESE TË UP-së F. 6


EKONOMI



BOK-ja NIS AKTIVITETET E MBËSHTETURA NGA BE-ja PËR THEMELIMIN E SISTEMIT TË KOSOVËS PËR MONITORIMIN E FALSIFIKIMIT TË PARASË F. 8

KURTI THOTË SE KOSOVA PO SHQYRTON MUNDËSINË PËR TA PËRDORUR GAZIN AMERIKAN NË TË ARDHMEN F. 8

SPORT



ARGJENTINA ELIMINON ANGLINË DHE KALON NË FINALIN E BOTËRORIT F. 10

KOS SHPREH HABI QË PAUNOVIQ VAZHDON TË JETË MINISTRE

BRUKSEL, 16 KORRIK - Komisionarja për Zgjerim e Bashkimit Evropian, Marta Kos, përsëriti dënimin e saj ndaj deklaratës së ministres të qeverisë serbe, Snezhana Paunoviq, lidhur me "spastrimin etnik" në Kosovë dhe shprehu habinë që ajo vazhdon të mbetet ministre. Kos u bëri thirrje politikanëve në vendet kandidate për anëtarësim në BE që të kenë parasysh se çdo fjalë e thënë ka peshë. "Ishte tronditëse të dëgjonim diçka të tillë në vitin 2026. Nuk do ta përsëris as atë që ajo tha. Ishte vërtet tronditëse të dëgjohej një deklaratë e tillë. Nuk mund ta imagjinoj që një ministre, pas një deklarate të tillë publike, të mund të vazhdojë të ushtrojë detyrën e saj", deklaroi komisionarja Kos gjatë fjalimit të saj në Komitetin e Posaçëm për Mburojën e Demokracisë Evropiane të Parlamentit Evropian. Ministrja e Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale në Qeverinë serbe, Snezhana Paunoviq, duke folur për jetën në Kosovë dhe largimin e saj nga Peja gjatë luftës, deklaroi më 11 korrik se "nuk do t'i kishte likuiduar shqiptarët ashtu siç ata po përpiqen ta pastrojnë etnikisht Kosovën, por në atë mënyrë që secili që ndihej më pak qytetar i Republikës Federale të Jugosllavisë, të largohej dhe të shkonte në shtetin e vet amë". Kjo deklaratë u dënua edhe nga Mbretëria e Bashkuar. Sipas Londrës, gjuha e



përdorur nga Paunoviq është "e neveritshme" dhe referencat për spastrim etnik s'kanë vend në shoqërinë e sotme. Përmes një deklarate, një zëdhënës i Zyrës për Punë të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar tha se në kohën kur shtetet në Ballkanin Perëndimor janë të përqendruara në ndërtimin e një të ardhmeje paqësore dhe shumetnike, "deklaratat si këto synojnë t'i rihapin

përçarjet e vjetra dhe të nxisin tensione". "Udhëheqësit e përgjegjshëm politikë duhet të refuzojnë një gjuhë të tillë", u tha në deklaratë. Presidenti serb Aleksandar Vuçiq ka reaguar për Paunoviqin, duke thënë se deklarata e saj nuk pasqyron vullnetin e tij e as të Qeverisë së Serbisë, duke shtuar se politika e shtetit serb është dialogu, kurrë spastrimi etnik.

Paunoviq - nënkryetare e Partisë Socialiste të Serbisë, partisë së dikurshme të Millosheviqit - nuk i tërhoqi fjalët e saj, por tha më 16 korrik se ato "janë nxjerrë jashtë kontekstit" dhe i kërkoi falje Vuçiqit dhe Qeverisë së Serbisë për reagimet që ka shkaktuar. Deklarata e saj se do ta spastronte etnikisht Kosovën nëse do të ishte në krye të shtetit më 1998 nxiti reagime të shumta dhe Kosova më 14 korrik e shpalli atë person të padëshiruar, duke ia ndaluar përgjithmonë hyrjen ose kalimin nëpër territorin e Kosovës. Vëzhgues nga Kosova dhe Serbia thanë Radion Evropa e Lirë se deklarata e Paunoviqit është pjesë e një modeli politik të Serbisë karshi Kosovës, duke kërkuar që bashkësia ndërkombëtare të mos mjaftohet vetëm me reagime, por të ndërmarrë veprime konkrete ndaj Serbisë. Nga Qeveria në detyrë e Kosovës i kanë thënë më herët Radios Evropa e Lirë se "problemi qëndron se shteti i Serbisë nuk ka bërë asnjëherë asnjë lloj distancimi nga politika e Millosheviqit". "Është mirë që të gjithë - përveçse ta dënojnë këtë gjuhë - ta kenë edhe në mendje kur flasin me Serbinë për integrimin, reformat dhe fondet, si dhe ta kuptojmë që këto nuk janë thjesht deklarime, por aspirata nga të cilat shteti zyrtar i Serbisë nuk ka hequr dorë", thanë nga ekzekutivi i Kosovës.

Udhëheqësit e atëhershëm shtetërorë dhe forcat e sigurisë së Republikës Federale të Jugosllavisë u dënuan nga Tribunali i Hagës për dëbimin me dhunë të qindra mijëra civilëve shqiptarë nga Kosova në periudhën mars-qershor të vitit 1999. Gjatë luftës në Kosovë, në vitet 1998-1999 u vranë më shumë se 13 000 civilë, ndërsa mijëra të tjerë u zhdukën. Më shumë se 1 500 persona, shumica prej tyre shqiptarë, vazhdojnë të jenë ende të zhdukur. Sipas të dhënave zyrtare të Komisionit Evropian, shkalla e harmonizimit të Serbisë me politikën e sanksioneve të BE-së është pak më shumë se 60 për qind. Deri më tani Serbia nuk ka vendosur sanksione ndaj Rusisë apo Bjellorusisë në përputhje me vendimet e bllokut evropian, i cili deri tani i ka miratuar Moskës 20 paketa sanksionesh si përgjigje ndaj agresionit kundër Ukrainës. Komisionarja Kos, duke folur para eurodeputetëve, vlerësoi se mbështetja e ulët për integrimin evropian në Serbi është edhe pasojë e mesazheve që dërgojnë politikanët si dhe e mënyrës se si raportojnë mediet. Ajo theksoi se është e papranueshme që një vend kandidat të përdorë retorikë antievropiane, veçanërisht kundër deputetëve të Parlamentit Evropian, gazetarëve dhe të gjithë atyre që kritikojnë zhvillimet në vend.

AEROPLANËT RAFALE, HAPI I UKRAINËS DREJT NJË FLOTE PERËNDIMORE

KIEV, 16 KORRIK - Nëse Franca e mban fjalën që e dha më 14 korrik që aeroplanët luftarakë Rafale do t'i dërgohen Ukrainës në një të ardhme të afërt, forcat ajrore të Kievit së shpejti do të operonin me tetë modele të ndryshme të aeroplanëve luftarakë, të dizajnuara në katër shtete të ndryshme. Parisi njoftoi më 14 korrik se katër nga 16 aeroplanët e llojit Dassault Rafale do t'i dërgohen Ukrainës sapo pilotët e vendit dhe ekipet e mirëmbajtjes të trajnohen për të operuar me këtë fluturake franceze. Trajnimet mund të nisin "po më 2026", sipas një deklarate të përbashkët të lëshuar nga Franca dhe Ukraina.

Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, forcat ajrore të Ukrainës trashëguan dhjetëra aeroplanë të epokës sovjetike, të cilët ende janë shtylla kryesore e flotës sulmuese ajrore. Por, që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës më 2022, aleatët perëndimorë e kanë furnizuar Kievin me aeroplanë të prodhimit amerikan F-16, por edhe me disa fluturake franceze Mirage 2000. Disa aeroplanë Gripen të Suedisë pritet të operohen nga pilotët ukrainas në fillim të vitit të ardhshëm dhe Rafalet pritet të jenë fluturaket e radhës. Operimi i një flote kaq të larmishme të fluturakeve luftarake zakonisht nuk preferohet nga ushtritë "për



shkak të humbjes së përfitimeve ekonomike dhe për shkak të nevojës për të krijuar sisteme trajnimi, mbështetjeje dhe mirëmbajtjeje për secilin

lloj aeroplani", tha për Radion Evropa e Lirë, Christoph Bergs, analist për fuqinë ajrore në Institutin Mbretëror të Shërbimeve të Bashkuara

(RUSI). Disa shtete të NATO-s operojnë me flota të përbëra vetëm nga një model i aeroplanëve luftarakë, ndërsa edhe forcat ajrore të mëdha, si ato të Gjermanisë dhe Francës, aktualisht përdorin vetëm dy lloje të fluturakeve sulmuese. Bergs tha se rritja e kompleksitetit të flotës ajrore luftarake të Ukrainës ka të ngjarë të jetë një hap drejt synimit afatgjatë të vendit për të hequr dorë plotësisht nga aeroplanët e epokës sovjetike. Mirëmbajtja e këtyre aeroplanëve po bëhet gjithnjë e më e vështirë për Kievin, pasi zinxhirët e furnizimeve me pjesë kyçe janë ndërprerë për shkak të armiqësive pasi Rusia aneksoi Krimenë më 2014.

ISMET KRYEZIU: KJO KLASË POLITIKE NUK KA AS KAPACITET E AS PËRGJEGJËSI PËR T'I NDËRTUAR DHE FUNKSIONALIZUAR INSTITUCIONET

Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se mosthirrja e seancës konstituive të Kuvendit dhe arsyetimi i presidentes në detyrë, Albulena Haxhiu, se partive politike duhet t'u lihet edhe më shumë kohë për negociata, është sa qesharak, aq edhe i papërgjegjshëm ndaj qytetarëve. Ndërkaq thotë se kërkesa për një president “jopartiak” synon një figurë të nënshtruar ndaj pushtetit

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 KORRIK - Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se mosthirrja e seancës konstituive të Kuvendit dhe arsyetimi i presidentes në detyrë, Albulena Haxhiu, se partive politike duhet t'u lihet edhe më shumë kohë për negociata, është sa qesharak, aq edhe i papërgjegjshëm ndaj qytetarëve. “Për më tepër, partitë kanë pasur kohë sa të duash për të negociuar dhe mund të vazhdojnë të negociojnë edhe pas konstituimit të Kuvendit. Nuk mund të mbahet peng përmbushja e një detyrimi kushtetues me arsyetimin se duhen edhe më shumë bisedime. Ndërkohë, vendi vazhdon, prej afro dy vitesh, të funksionojë me institucione në detyrë dhe me zgjidhje të improvizuara. Nëse gati dy vjet, së bashku me tri palë zgjedhje të mbajtura, nuk po mjaftojnë për të arritur qoftë edhe një marrëveshje minimale, sa kohë tjetër u duhet? Dhe me çfarë arsyetimi?”, ka shkruar ai në “Facebook”.

Kryeziu ka thënë se po aq e papërgjegjshme është edhe qasja e partive opozitare. “Deri më tani ato nuk kanë bërë asnjë kërkesë publike dhe asnjë veprim konkret për konstituimin sa më të shpejtë të Kuvendit. Kjo situatë, së bashku me paaftësinë për të tejkaluar interesat partiake dhe individuale, po e normalizon një perceptim, se kjo klasë politike, këta akterë aktual, nuk kanë as kapacitetin dhe as përgjegjësinë për të ndërtuar, funksionalizuar dhe mirëmbajtur institucionet e një shteti demokratik. Shkalla e zhvillimit demokratik nuk matet



vetëm me organizimin e zgjedhjeve, por edhe me aftësinë për ta shndërruar vullnetin e qytetarëve në institucione funksionale, efektive dhe llogaridhënëse”, ka thënë Kryeziu.

Ai ka folur edhe për zgjedhjen e presidentit dhe kriteret për zgjedhjen e tij. “Gati për dy vite partia në pushtet po na thotë se kriteri kryesor për presidentin nuk është respektimi i Kushtetutës, por mungesa e një të kaluar politike e partiake. Sikur vetë fakti që dikush që vjen nga politika dhe nga një parti nënkupton domosdoshmërisht se nuk do ta respektojë Kushtetutën, ndërsa një personalitet nga jashtë politikës bëhet automatikisht gardian kushtetues. Kjo teori na çon te

një përfundim tjetër: se në jetën tonë politike partia është më e fuqishme se çdo institucion dhe çdo pushtet kushtetues. Pra, nëse zgjedhim dikë me të kaluar politike e partiake, automatikisht paskemi hequr dorë nga respektimi i Kushtetutës.

Por, nëse kjo është e vërtetë, atëherë kriteret kushtetuese për presidentin vërtet nuk kanë më arsye të diskutohen. Sepse problemi nuk është te kandidati, por te vetë sistemi politik që kemi ndërtuar”, ka thënë ai.

Kryeziu ka thënë se sot për postin e presidentit flitet për figura me prapavijë shkencore, akademike, publike e gjithfarë profilesh. “Shumë mirë. Por ku ishte zëri i këtyre profileve gjatë zhvillimeve më të rëndësishme politike e kushtetuese në

Kosovë? Kur folën? Kur vepruan? Për çfarë mbajtën qëndrim? Prej kur heshtja publike dhe inferioriteti nga jeta politike u bënë dëshmi e pavarësisë, ndërsa angazhimi publik e politik mangësi për të qenë president? Në fakt, partia në pushtet nuk duket se ia ka frikën një presidenti që mund të bëjë veprime kundërkushtetuese. Por, ia ka frikën një presidenti që ka mendim politik. Një presidenti që jo gjithmonë pajtohet me veprimet e pushtetit, që ka zë publik dhe që, kur duhet, mund të thotë jo”, është shprehur Kryeziu në një analizë të publikuar në rrjetet sociale.

Prandaj, sipas tij, kërkohet një president pa të kaluar partiake e, mundësisht, pa peshë politike.

“Një figurë pa zë institucional, që pret delegacione, ndan dekorata dhe hesht për politikën”, ka thënë ai.

Kryeziu ka thënë se kërkesa ndaj opozitës që të pranojë medoemos një kandidat “jopartiak” nuk është kërkesë për kompromis dhe konsensus politik. “Është kërkesë që opozita të bëjë kompromis me koncentrimin e pushtetit politik në duart e një njeriu - kryeministrit të Kosovës. Prandaj pyetja është e thjeshtë: çfarë arsyeje politike, institucionale apo kushtetuese ka opozita ta japë këtë konsensus? Një president ‘mbi partitë’ tingëllon bukur. Por një president nën pushtetin është diçka krejt tjetër”, ka deklaruar Kryeziu.

Veseli dhe Krasniqi mbeten në paraburgim, gjykata ua refuzon kërkesat për lirim të përkohshëm




PRISHTINË, 16 KORRIK - Dhomat e Specializuara në Hagë kanë bërë me dije se Trupi Gjykses II ka vendosur ta vazhdojë masën e paraburgimit për Kadri Veselin dhe Jakup Krasniqin, duke i refuzuar njëherësh kërkesat e tyre për lirim të përkohshëm.

Sipas njoftimit zyrtar, në vendimet e marra më 15

korrik 2026, Trupi Gjykses vlerësoi se vazhdojnë të ekzistojnë rreziqe konkrete që të akuzuarit mund ta pengojnë ecurinë e procesit gjyqësor ose të kryejnë krime të tjera, duke e bërë të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit. “Në vendimet e fundit lidhur me rishikimin e paraburgimit të 15 korrikut

2026, Trupi Gjykses II urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit dhe rrëzoi kërkesat e tyre për lirim të përkohshëm. Trupi Gjykses konstatoi se ekzistojnë ende rreziqet se të akuzuarit mund të pengojnë ecurinë e procesit ose të kryejnë krime të tjera”, thuhet në njoftim.



ÇFARË MUND TA NDALË GJUHËN E ASHPËR TË SERBISË KARSHI KOSOVËS?

Pas deklaratës së një ministreje serbe se do ta “spastronte etnikisht” Kosovën, vëzhguesit në Kosovë dhe në Serbi paralajmërojnë se retorika e tillë pasqyron modelin politik të Serbisë karshi fqinjit të saj. Ata kërkojnë që bashkësia ndërkombëtare të bëjë më shumë sesa deklarata dënuese, që kjo gjuhë të ndalet. Fjalët e Snezhana Paunoviçit janë vetëm shembulli më i fundit i retorikës kundër shqiptarëve nga zyrtarë të lartë serbë ndër vite

PRISHTINË, 16 KORRIK - Deklarata e një ministreje të Qeverisë së Serbisë se do ta “spastronte etnikisht” Kosovën po të ishte në krye të shtetit më 1998, për vëzhguesit në Kosovë dhe në Serbi është pjesë e një modeli politik të Serbisë karshi Kosovës. Ata kërkojnë që bashkësia ndërkombëtare të mos mjaftohet vetëm me reagime, por të ndërmarrë veprime konkrete ndaj Serbisë. Bekim Blakaj nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë thotë se as mediet, as shoqëria civile s’mund ta ndryshojnë gjuhën dhe qëndrimin e Serbisë karshi Kosovës. Por, ai thekson se Bashkimi Evropian ka në duar instrumente, në kuadër të rrugës evropiane të Serbisë, për të parandaluar një retorikë të tillë. “Mund t’i vendosë disa sanksione, do të thosha, në

mënyrë që ta zvogëlojë këtë farë qëndrimi zyrtar të Serbisë, kur bëhet fjalë për Kosovën, për stigmatizimin e shqiptarëve dhe moslejimin e realizmit të marrëdhënieve mes dy vendeve dhe dy shoqërive”, thotë ai. Sipas Blakajt, instrumente të tilla veçse përfshihen në kapitujt e negociatave të anëtarësimit në BE, “mirëpo mund të jenë edhe më specifike - tekefundit, të bëjnë edhe një lloj presioni ndërkombëtar kur ndodhin këto fjalime nga zyrtarët serbë”.

Bashkimi Evropian, i cili e ka kushtëzuar përparimin e Kosovës dhe Serbisë në rrugën drejt anëtarësimit me normalizimin e marrëdhënieve, e dënoi deklaratën që ministrja serbe e Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes Lokale, Snezhana Paunoviç, bëri më 11

korrik në televizionin serb, “Kurir”. Sipas BE-së, ajo “është në kundërshtim me vlerat e dinjitetit njerëzor, pajtimin, përgjegjësisë dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë”.

“Shiptari” e “të dalë nga mali”

Por, Paunoviç nuk është zyrtarja e vetme që ka bërë deklarata fyese apo nxitëse ndaj shqiptarëve.

Ana Bërnabiq, kur ishte kryeministre e Serbisë më 2019, tha se udhëheqësit e Kosovës ishin njerëz “të dalë nga mali” dhe “u bënë pjesë e elitës politike”.

Bërnabiq, më vonë si kryetare e Kuvendit, përdori edhe termin fyesh “shiptari”, duke iu referuar medieve në Kosovë.

Ndonëse shqiptarët e quajnë veten “shqiptarë”, termi “shiptar” në gjuhën serbe konsiderohet fyesh.

Forma neutrale dhe zyrtare është “Albanci”. Në vitin 2018, një gjykatë në Serbi konstatoi se përdorimi i termit “shiptar” përbën gjuhë të urrejtjes.

Megjithatë, këtë term e kanë përdorur në disa raste edhe zyrtarë të tjerë të lartë serbë, përfshirë Aleksandar Vullinin, i cili ndër vite ka mbajtur poste të rëndësishme në Qeverinë e Serbisë, si dhe ish-drejtori i Zyrës për Kosovën në qeverinë serbe, Marko Gjuriq, aktualisht ministër i Jashtëm.

Objekt i ofendimeve kanë qenë edhe zyrtarë të lartë të Kosovës. Së voni, presidenti serb Aleksandar Vuçiq e quajti kryeministrin në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, “fundërrinë terroriste”, ndërsa drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviç, iu referua atij si “Hitleri i vogël”.

“Model politik”

Historiani serb Sërgjan Millosheviç thotë se qasja e

pushtetit në Serbi ndaj shqiptarëve është karakterizuar prej dekadash nga retorika “degraduese, çnjerëzore dhe haptazi shoviniste”, e cila, sipas tij, i paraqet shqiptarët si një “kërcënim demografik dhe qytetëruar”.

Ai thotë se rasti i Paunoviçit është pjesë e një modeli të kahershëm politik, ku shqiptarët nuk trajtohen si qytetarë të barabartë, por reduktohen në numra, natalitet dhe kërcënim për serbët. “Pas krimeve të kryera gjatë viteve ‘90, një gjuhë e tillë paraqet vazhdimin e një lloji ‘kontributi vullnetar’ të Serbisë zyrtare për pavarësinë e Kosovës, sepse konfirmon pikërisht politikën e poshtërimit dhe përjashtimit, e cila vazhdon ta shkatërrojë mundësinë e jetesës së përbashkët”, thotë ai.

Për Blakajin, kjo gjuhë tregon se elita politike në Serbi nuk është shkëputur asnjëherë nga politika që ka udhëhequr ish-presidenti i Republikës Federale të Jugosllavisë, Slobodan Millosheviç - i akuzuar për krime lufte nga Tribunali i Hagës - karshi Kosovës. “Asnjëherë nuk kemi dëgjuar

KOSOVA DORËZON RAPORTIN PËR ZBATIMIN E REFORMAVE NGA PLANI I RRITJES



Bujar Teretona (RFE/RL)

PRISHTINË, 16 KORRIK - Kosova e ka dorëzuar raportin për zbatimin e hapave reformues në kuadër të Planit të Rritjes, konfirmuan për Radion Evropa e Lirë burime nga Komisioni Evropian (KE).

Kosova ishte vendi i fundit që dorëzoi raportin, më 15 korrik, ndërsa afati skadoi po në mesnatë të asaj dite.

Ndërkaq, burimet shtuan se nuk prisnin që Bosnjë-Hercegovina të dorëzonte ndonjë dokument, pasi Sarajeva është e vetmja që nuk ka miratuar Agjendën e Reformave dhe, rrjedhimisht, nuk i ka nënshkruar as marrëveshjet për financim dhe hua.

Pas pranimit të raporteve nga shtetet, Komisioni Evropian do të vlerësojë se deri ku kanë arritur vendet e rajonit në zbatimin e reformave.

Pas pranimit të raporteve nga shtetet, Komisioni Evropian do të vlerësojë se deri ku kanë arritur vendet në zbatimin e reformave. Më pas, në bazë të vlerësimit për rezultatet e arritura, përcaktohet shuma që secili shtet merr. "Pas pranimit të raporteve, Komisioni do të vlerësojë zbatimin e hapave përkatës reformues dhe do të marrë vendim për disbursimin e fondeve përkatëse", deklaroi më 15 korrik për Radion Evropa e Lirë (REL) zëdhënësi i Komisionit Evropian, Guillaume Mercier.

Më 30 qershor skadoi afati për periudhën e katërt të raportimit lidhur me përmbushjen e hapave reformues në kuadër të Planit të Rritjes.

Përveç kësaj, më 30 qershor 2026 skadoi edhe e ashtuquajtura periudha "grejs"

që Komisioni Evropian kishte miratuar për hapat reformues që fillimisht ishte paraparë të përfundonin në mesin e vitit 2025.

Për hapat reformues, afatet e të cilëve ishin fundi i vitit 2024 dhe fundi i vitit 2025, periudhat përkatëse "grejs" skadojnë më vonë gjatë vitit 2026.

Përveç dallimeve mes vendeve të rajonit në shkallën e zbatimit të hapave reformues, ekzistojnë edhe dallime në pagesat e deritanishme nga Komisioni Evropian.

Deri më tani, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi kanë marrë tri pagesa të rregullta nga fondet e Planit të Rritjes të Bashkimit Evropian. Serbia ka marrë vetëm një pagesë.

Ndërkaq, Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina nuk kanë marrë

asnjë pagesë të rregullt.

Deri më tani Prishtina ka marrë vetëm parafinancimin prej mbi 61 milionë eurosh, që përfaqëson shtatë për qind të shumës së përgjithshme prej 882 milionë eurosh të ndara për vendin.

Buxheti i përgjithshëm i Planit të Rritjes të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor është 6 miliardë euro për periudhën 2024-2027. Prej tyre, 2 miliardë euro janë grante, ndërsa 4 miliardë euro janë kredi me kushte të favorshme.

Fondet janë ndarë sipas dy kriterëve kryesore: numrit të banorëve dhe prodhimit të brendshëm bruto për kokë banori.

KE-ja i ka kombinuar këta tregues për ta përcaktuar çelësin proporcional të shpërndarjes ndërmjet gjashtë

përfutueseve, duke u kujdesur që vendet më të mëdha të marrin një shumë më të madhe, por duke marrë parasysh edhe nevojat e tyre ekonomike. Sipas këtyre kriterëve, Serbisë i janë ndarë 1.58 miliard euro, Bosnjë-Hercegovinës 976.6 milionë euro, Shqipërisë 922.1 milionë euro, Kosovës 882.6 milionë euro, Maqedonisë së Veriut 750.4 milionë euro, ndërsa Malit të Zi 383.5 milionë euro. Më herët gjatë këtij viti, komisionarja evropiane për Zgjerim, Marta Kos, paralajmëroi se rajoni rrezikonte të humbiste rreth 700 milionë euro për shkak të vonesave në përmbushjen e reformave. Nëse shtetet nuk përmbushin reformat me kohë, fondet humben. Ato më pas kthehen në buxhetin e bllokut evropian.

asnjë zyrtar të lartë serbë që ka shprehur keqardhje për krimet e kryera ndaj shqiptarëve, që i ka pranuar viktimat, që ka folur për varrezat masive që janë gjetur në Serbi", thotë Blakaj. Ai paralajmëron se deklarata si ato të Paunoviqit, të cilat i cilëson si "luftënxitëse", mund të shtyjnë individë ose grupe që, "kur të krijohen kushtet", t'i shndërrojnë paragjykimet dhe stigmatizimin ndaj shqiptarëve në veprime konkrete.

Si shembull, ai përmend sulmin e armatosur ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë, më 2023.

Reagimet në Kosovë dhe Serbi

Disa serbë të Kosovës i thanë Radios Evropa e Lirë se deklarata të tilla janë "problematike" dhe se, në fund, dëmtojnë vetë komunitetin

serb që jeton në Kosovë. Qeveria në detyrë e Kosovës, e cila e shpalli Paunoviqin person të padëshiruar, tha se Serbia nuk është distancuar asnjëherë nga politika e Millosheviqit. Sipas saj, qëndrimet e tilla nuk janë thjesht deklarime, por "aspirata nga të cilat shteti zyrtar i Serbisë nuk ka hequr dorë". Presidenti serb, Vuçiq, tha se deklarata e Paunoviqit nuk pasqyron politikën zyrtare të

Serbisë. Vetë Paunoviq - nënkryetare e Partisë Socialiste të Serbisë, partisë së dikurshme të Millosheviqit - nuk i tërhoqi fjalët e saj, por tha se ato "janë nxjerrë jashtë kontekstit" dhe i kërkoi falje Vuçiqit dhe Qeverisë së Serbisë për reagimet që ka shkaktuar. Gjatë luftës në Kosovë, më 1998-1999, u vranë mbi 13 000 civilë, ndërsa më shumë se 1 500 persona - shumica

shqiptarë - vazhdojnë të jenë të zhdukur. Tribunali i Hagës konstatoi se udhëheqësit e Jugosllavisë së atëhershme dhe drejtuesit e aparatit të sigurisë ishin pjesë e një "ndërmarrjeje të përbashkët kriminale", që synonte dëbimin me forcë të qindra mijëra shqiptarëve nga Kosova. Për krime kundër shqiptarëve të Kosovës u dënuan disa zyrtarë të lartë politikë, policorë dhe ushtarakë serbë.

Këshilli Gjyqësor thekson rëndësinë e vazhdim të bashkëpunimit me EULEX-in për sundimin e ligjit

PRISHTINË, 16 KORRIK - Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Rustem Thaqi, priti në takim njoftues ushtruesen e detyrës së shefit të EULEX-it, Emily Rakhorst, e cila shoqërohej nga Giovanni Galzignato, shef i Komponentit të Drejtësisë dhe Shërbimit Korrektues, Hubert van Eck Koster, shef i Njësisë për Monitorimin e Rasteve, si dhe Valentina Vitali, këshilltare për të Drejtat e Njeriut. Me këtë rast, Rakhorst e uroi kryesuesin Thaqi për marrjen e detyrës,

duke i dëshiruar suksese në ushtrimin e mandatit të tij. Ajo ritheksol përkushtimin e EULEX-it për ta vazhduar bashkëpunimin dhe mbështetjen ndaj sistemit gjyqësor të Kosovës në përputhje me mandatin e misionit.

Nga ana e tij, kryesuesi Thaqi e falënderoi Rakhorstin për vizitën dhe urimin, duke vlerësuar bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe

EULEX-it. Ai theksol rëndësinë e vazhdim të këtij bashkëpunimi në funksion të forcimit të sundimit të ligjit, pavarësisë së gjyqësorit dhe avancimit të efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor.

Bashkëbiseduesit diskutuan edhe për zhvillimet aktuale në sistemin gjyqësor, sfidat me të cilat përballlet ai, si dhe mundësitë për thellimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët.



SENATI FORMON KOMISIONIN PËR STANDARDIZIMIN E DOKUMENTEVE DHE MATERIALEVE PROMOVUESE TË UP-së

PRISHTINË, 16 KORRIK - Në mbledhjen e fundit, Senati i Universitetit të Prishtinës ka emëruar dy anëtarë të tij për monitorimin e zbatimit të Planit të ri Strategjik të UP-së 2026-2030 dhe caktoi komisionin që do t'i dizajnojë modelet e dokumenteve zyrtare dhe materialeve promovuese të universitetit.

Me qëllimin e përkrahjes dhe promovimit të punës dhe hulumtimeve shkencore cilësore në UP, senatorët miratuan edhe vendimin në lidhje me kriteret për njohjen e publikimeve shkencore për librim me pagesë nga mësimdhënia dhe shtynë për mbledhjen e radhës shqyrtimin e publikimeve në revistat me

pagesë dhe ato me autor të parë në një kërkim shkencor të zhvilluar në bashkautorësi.

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për rritjen e bashkëpunimit dhe mobilitetit të brendshëm mes njësisë akademike të UP-së, senati transferoi një profesor nga Fakulteti i Edukimit në Fakultetin Filozofik.

Edhe në këtë mbledhje vazhdoi punësimi i personelit të ri akademik pasi u vendos edhe për disa pozita të tjera të shpallura në konkursin publik të 8 janarit 2026, si dhe për rizgjedhjet dhe avancimet nga konkurset e brendshme nëpër njësitë akademike.

Senatorët u informuan edhe për

vendimet e këshillave të fakulteteve për bashkëpunëtorët e jashtëm të nevojshëm në vitin akademik 2026/27.

Në mbledhjen e korrikut të Senatit të Universitetit të Prishtinës u bë edhe plotësimi i Këshillit Drejtues të Bibliotekës Qendrore Universitare dhe Komisionit për Cilësi.

Senati miratoi edhe pesë tema doktrorate, ratifikoi dy prej tyre dhe ndërroi një mentor të një teme të këtyre studimeve, duke konfirmuar me të gjitha vendimet angazhimin e pandërprerë për forcimin e cilësisë akademike, ruajtjen e integritetit institucional dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Universitetit të Prishtinës.



OPERACION ANTIDROGË NË PRISHTINË. ARRESTOHEN DY PERSONA, KONFISKOHEN RRETH 150 GRAMË KOKAINË



PRISHTINË, 16 KORRIK - Hetuesit policorë nga Njësia e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë (DHTN), Prishtinë, kanë trajtuar një rast rreth dyshimit se një i dyshuar është duke u marrë me shitblerje të substancave narkotike. Pas një pune operative-hetimore, më 15.07.2026, në magjistratën Pejë - Prishtinë, është lokalizuar i dyshuari F. P., (viti i lindjes 1992,

maskull kosovar), i cili ishte në një veturë.

Në veturë dhe në shtëpinë e të dyshuarit janë gjetur dhe janë konfiskuar 147.7 gramë substancë që dyshohet të jetë narkotike e llojit kokainë dhe dëshmi të tjera relevante lidhur me rastin. Rasti është trajtuar në koordinim me prokurorin kujdestar. Po ashtu, është bastisur edhe shtëpia e një të

dyshuari tjetër: Q. K., (viti i lindjes 1993, maskull kosovar), por nuk është gjetur asgjë e ndaluar. Ndaj të dyshuarve është iniciuar rasti 'blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave, psikotrope dhe analoge'. Të dyshuarit me aktvendim të prokurorit janë dërguar në mbajtje për 48 orë.

Kurti pret ambasadorin Almqvist, kërkon statusin e vendit kandidat dhe hapjen e negociatave për anëtarësim

PRISHTINË, 16 KORRIK - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim ambasadorin jorezident të Irlandës për Kosovën, Ragnar Almqvist, dy javë pasi Irlanda mori Presidencën e Këshillit të Bashkimit Evropian. Përmes një postimi në "Facebook", Kurti e cilësoi Irlandën si shtet mik dhe partner të rëndësishëm të Kosovës, ndërsa theksol se statusi kandidat dhe hapja e

negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian janë njohje e meritës për reformat dhe progresin që Kosova ka dëshmuar. "Dy javë pasi Irlanda mori Presidencën e Këshillit të Bashkimit Evropian, pata kënaqësinë të mirëpres në zyrën time ambasadorin jo-rezident, Ragnar Almqvist. Irlanda është shtet mik dhe partner i rëndësishëm për Republikën e Kosovës. Ne jemi mirënjohës për përkrahjen e vazhdueshme dhe kontributin e saj në kuadër të

KFOR-it dhe EULEX-it. Republika e Kosovës është demokracia më e avancuar në rajon, ka mesataren më të lartë të rritjes ekonomike dhe, krahas mbështetjes së lartë qytetare për BE-në, është plotësisht e linjësuar me politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë. Statusi kandidat dhe hapja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian janë njohje e meritës për reformat dhe progresin që Kosova ka dëshmuar", ka shkruar Kurti.



ABDIXHIKU: PAS NISMËS PËR SHKARKIMIN TIM, NDËRPRES ANGAZHIMIN PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE



PRISHTINË, 16 KORRIK - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se detyrohet t'i ndërpresë bisedimet me Lëvizjen Vetëvendosje për formimin e institucioneve të reja të Kosovës për shkak të zhvillimeve brenda partisë. Përmes një video të publikuar në rrjetet sociale, Abdixhiku tha se e ka autorizuar sekretariatit e partisë t'i nisë procedurat për mbajtjen e një kuvendi të jashtëzakonshëm partiak, pasi gjatë ditës 148 delegatë të Kuvendit të LDK-së dorëzuan nënshkrimet për mbajtjen e tij me kërkesën për shkarkimin e kreut partiak.

Pas verifikimit të nënshkrimeve, Abdixhiku tha se do të caktohet data dhe vendi i mbajtjes së Kuvendit. "Për shkak të kësaj nisme, detyrohem t'i ndërpresë gjitha angazhimet për formimin e institucioneve të Republikës që i prisni me të drejtë tash e sa kohë", tha Abdixhiku. Sipas tij, nuk do të ishte serioze e as e përgjegjshme që ai të vazhdojë të negociojë në emër të LDK-së, "ndërkohë që mandati im për të udhëhequr dhe përfaqësuar atë është vënë në diskutim brenda shtëpisë sime". "Ndiej keqardhje që sot jam i detyruar ta kthejmë vëmendjen sërish nga vetja te një proces që mund

të na dëmtojë pariparueshëm nga brenda dhe ta lërë Kosovën pa institucione dhe potencialisht përballë zgjedhjeve të reja në vjeshtë", tha Abdixhiku.

Abdixhiku tha se nuk beson që bisedimet me kreun e Lëvizjes Vetëvendosje, kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, të kenë qenë arsyeja për thirrjen e Kuvendit partiak nga 148 anëtarë të LDK-së. Sipas tij, në historinë 37-vjeçare nuk ka pasur praktikë në LDK që kreu i saj të shkarkohet pak muaj para zgjedhjeve të rregullta partiake dhe pak muaj pas konfirmimit të mandatit të tij.

Më 10 korrik Abdixhiku së bashku me ish-presidenten Vjosa Osmani zhvilluan diskutime me Kurtin për çështjen e themelimit të institucioneve të reja pas zgjedhjeve të qershorit. Ndonëse palët pas takimit nuk raportuan për ndonjë rezultat, Kurti dhe Abdixhiku shprehën gatishmëri për vazhdimin e bisedimeve për një marrëveshje për institucionet e reja.

Ndërkaq, pak para se Abdixhiku të dilte me njoftimin për ndërprerjen e angazhimit për krijimin e institucioneve të reja, mediet në Kosovë raportuan se në mes të LDK-së dhe LV-së ishte arritur në parim

një marrëveshje për ndarjen e posteve kyçe shtetërore, por zyrtarizimi i saj nuk ishte bërë për shkak të situatës së brendshme në partinë e Abdixhikut.

Burime brenda LDK-së i thanë Radios Evropa e Lirë se këto raportime nuk qëndrojnë. "Nuk ka ndonjë marrëveshje", thanë për REL burime brenda LDK-së.

REL i është drejtuar edhe LV-së për koment për këtë çështje, por ende nuk ka marrë ndonjë përgjigje.

Dorëzimi i nënshkrimeve

Më herët gjatë së mërkurës, deputeti i zgjedhur i LDK-së, Armend Zemaj, ka tha se janë mbledhur dhe dorëzuar nënshkrimet e nevojshme për ta thirrur një kuvend të jashtëzakonshëm të partisë.

Derisa po dilte nga zyra e LDK-së në Prishtinë së bashku me kryetarin e degës së dytë, Florian Dushi, Zemaj tha se numri i nënshkrimeve të dorëzuara ishte i njëjtë me atë që kishte deklaruar ditë më parë, mbi 150. Sipas Statutit të LDK-së, kuvendi i jashtëzakonshëm mund të thirret me kërkesën e të paktën 1/3 së delegatëve të Kuvendit. Kuvendin e partisë e përbëjnë 354 delegatë të zgjedhur në

kuvendet e degëve, plus kryetari aktual i LDK-së, që me automatizëm është delegat i Kuvendit të Përgjithshëm të LDK-së.

Grumbullimi i nënshkrimeve të nevojshme vjen pas përplasjeve të hapura brenda LDK-së dhe pakënaqësive me Abdixhikun, pasi partia doli e treta në zgjedhjet parlamentare të qershorit, duke fituar 18 vende në Kuvendin e Kosovës me 120 deputetë. Po ashtu, ky zhvillim po ndodh në një kohë kur Abdixhiku nisi javën e kaluar bisedimet me liderin e partisë fituese, Albin Kurtin e Lëvizjes Vetëvendosje, në përpjekje për të arritur një marrëveshje për formimin e institucioneve të reja.

Çfarë ndodhi?

Pasi LDK-ja, e cila garoi në një listë të përbashkët me ish-presidenten Vjosa Osmani, dështoi të arrijë rezultat bindës zgjedhor më 7 qershor, filluan zëra pakënaqësish brenda partisë, të cilët nuk ishin diçka e re, gjithsesi.

Në fund të qershorit së paku dy kryetarë komunash dhe disa drejtues degësh kërkuan publikisht dorëheqjen e Abdixhikut, duke argumentuar se ai duhet të marrë përgjegjësi

për rezultatin zgjedhor dhe për mungesën e një rritjeje të ndjeshme elektorale.

Abdixhiku iu përgjigj kritikëve me kundërkërkesë, duke u bërë thirrje atyre të japin dorëheqje. Kjo nuk është hera e parë që kërkohej dorëheqja e Abdixhikut, pasi ngjashëm ndodhi edhe në janar të këtij viti, pas zgjedhjeve parlamentare të dhjetorit. Në janar ai i mbijetoi një votëbesimi që e kishte kërkuar vetë në kuvendin e jashtëzakonshëm të partisë. Por, disa figura partiake kishin kërkuar dorëheqjen e tij të parevokueshme, duke mos u pajtuar me votëbesim. Në mesin e tyre ishte Hykmete Bajrami, e cila ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e nënkryetares së partisë.

Para atij Kuvendi, anëtari tjetër i kësaj partie, Avdullah Hoti, e shpalli kandidaturën për kryetar të partisë, por delegatët diskutuan vetëm për performancën e Abdixhikut. Lidhja Demokratike e Kosovës është një nga partitë më të vjetra në Kosovë, e themeluar në vitin 1989 nga Ibrahim Rugova. Ajo ka luajtur rol kyç në periudhën e rezistencës paqësore dhe në ndërtimin e institucioneve demokratike të vendit.

Shoqata e Prodhuesve të Qumështit kërkon ndarjen e produkteve të qumështit nga ato me bazë bimore në markete

PRISHTINË, 16 KORRIK - Shoqata e Prodhuesve të Qumështit e Kosovës ka përsëritur kërkesën që në marketet e vendit produktet e qumështit me origjinë shtazore të vendosen veçmas nga produktet me bazë bimore me qëllim që konsumatorët të kenë të qartë se çfarë po blejnë. Sipas shoqatës, ndarja e këtyre produkteve do ta shmangte

konfuzionin mes produkteve me origjinë shtazore dhe atyre me bazë bimore. Megjithatë, ajo thekson se kjo kërkesë ende nuk po zbatohet në shumë markete të Kosovës. Për këtë arsye, Shoqata u ka bërë thirrje institucioneve përgjegjëse t'i forcojnë kontrollet dhe ta sigurojnë zbatimin e kësaj kërkesë. Po ashtu, ajo ka bërë thirrje që institucionet

vendimmarrëse të tregojnë më shumë vendosmëri në zbatimin e legjislacionit, me synim mbrojtjen e konsumatorëve dhe garantimin e një tregu të drejtë e transparent. Shoqata e Prodhuesve të Qumështit e Kosovës ka bërë me dije se do të vazhdojë angazhimin për mbrojtjen dhe promovimin e prodhimit vendor.

**KURTI THOTË SE KOSOVA PO SHQYRTON MUNDËSINË PËR TA PËRDORUR GAZIN AMERIKAN NË TË ARDHMEN**

PRISHTINË, 16 KORRIK - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se vendi po e shqyrton mundësinë për ta përdorur gazin e lëngëzuar (LNG) nga Shtetet e Bashkuara në të ardhmen, mes thirrjeve të vazhdueshme për t'iu bashkuar projektit të aleatit të vet më të madh për furnizim me LNG. Kurti i bëri këto komente gjatë vendosjes së gurthemelit për ndërtimin e një parku solar me kapacitet prej 105 megavatesh në Rahovec në jugperëndim të vendit. “Për të ardhmen, synojmë përdorimin e thëngjillit në mënyrë më të përgjegjshme, me theks të veçantë të gazifikimit të tij, dhe po e shqyrtojmë mundësinë për ta përdorur gazin e lëngëzuar nga Shtetet e Bashkuara përmes

bashkëpunimit me Shqipërinë në termocentralin e Vlorës”, tha Kurti. Qeveria në detyrë është përballur me thirrje të vazhdueshme nga Ambasada Amerikane në Prishtinë e deri tek odat ekonomike në vend dhe opozita, për të hyrë në projektet e gazit amerikan. Në fund të qershorit ministria në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, nguli këmbë se Kosova nuk është kundër gazit të lëngëzuar amerikan dhe shtoi se vendi do ta trajtonte këtë çështje “me shumë seriozitet”. Ngjashëm sikurse Kurti, edhe Rizvanolli kishte thënë se qeveria në detyrë e sheh gazifikimin e thëngjillit si mundësi më të mirë se furnizimin me LNG-në amerikane. Megjithatë, kjo është hera që Kurti apo kushdo qoftë



nga qeveria e tij thonë se po e shqyrtojnë thirrjen e aleatit kryesor të Kosovës për t'u furnizuar me LGN-në amerikane. Në Kosovë 90 për qind e energjisë elektrike prodhohet ende nga thëngjilli dhe vetëm rreth 10 për qind vjen nga burime të ripërtërishme si uji, era dhe dielli. Por, vendi varet nga importi

gjithashtu, posaçërisht në kohët e pikut të dimrit dhe verës. Ndërkohë, Oda Ekonomike Amerikane dhe Oda Ekonomike e Kosovës paralajmëruan rishitazi se refuzimi i projekteve rajonale të LNG-së rrezikon të ketë ndikim negativ në partneritetin e Kosovës me Shtetet e Bashkuara. Në disa raste Oda Ekonomike Amerikane ka argumentuar se përfshirja e Kosovës në infrastrukturën rajonale të projektit amerikan do ta rriste sigurinë energjetike, do t'i diversifikonte burimet e furnizimit dhe do ta bënte vendin më tërheqës për investime. Debatimi është shtuar edhe pasi e ngarkuara me punë në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, Anu Prattipati, ka publikuar në fillim të qershorit një opinion, ku i ka bërë thirrje

Kosovës të hyjë në një partneritet afatgjatë energjetik me Shtetet e Bashkuara përmes gazit amerikan. Njohësit e zhvillimeve që ndërlidhen me energjetikën në Kosovë vlerësojnë se ShBA-ja po bën përpjekje që t'i mos i lërë vendet e Ballkanit Perëndimor të cenueshme përballë ndikimit rus dhe ndikimeve të tjera në sektorin e energjisë. Disa shtete të Ballkanit Perëndimor kanë nënshkruar marrëveshje me kompani amerikane dhe ShBA-në për ta zgjeruar rrjetin e gazit. Në mesin e tyre Shqipëria, Kroacia dhe Bosnjë-Hercegovina. Rishitazi është nënshkruar një projekt i madh për ndërtimin e një tubacioni gazi që synon ta shkëpusë Sarajevën nga furnizimet ruse.

BQK-ja NIS AKTIVITETET E MBËSHTETURA NGA BE-ja PËR THEMELIMIN E SISTEMIT TË KOSOVËS PËR MONITORIMIN E FALSIFIKIMIT TË PARASË

PRISHTINË, 16 KORRIK - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) në bashkëpunim me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Programin e Bashkimit Evropian për Çështjet e Brendshme (Home Affairs Programme - HAPE), organizoi një takim të përbashkët koordinues për të diskutuar themelimin e Sistemit për Parandalimin dhe Luftimin e Falsifikimit të Parasë në Kosovë. Projekti synon ta mbështesë

Republikën e Kosovës në krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës kombëtar për parandalimin, zbulimin, monitorimin dhe luftimin e falsifikimit të parasë, plotësisht të harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian dhe të Eurosistemit. Ky projekt ndërtohet mbi rezultatet e asistencës teknike të ofruar më herët përmes instrumentit TAIEIX të Bashkimit Evropian, i cili u zbatua në bashkëpunim të ngushtë me Bankën Kombëtare



të Kroacisë. Si rezultat i këtij bashkëpunimi është hartuar Projektligji për Parandalimin dhe Luftimin e Falsifikimit të Parasë i cili përcakton kornizën institucionale për funksionimin e sistemit, përgjegjësitë e institucioneve përkatëse, si dhe themelimin e Sistemit të

Kosovës për Monitorimin e Falsifikimit të Parasë. Gjatë takimit pjesëmarrësit diskutuan për objektivat e projektit, metodologjinë e zbatimit dhe fazën e parë të aktiviteteve, e cila përfshin një vlerësim të gjithanshëm të kapaciteteve ligjore, institucionale dhe teknike të të gjitha institucioneve pjesë-marrëse. Zëvendësguvernatori i BQK-së, Dardan Fusha, theksoi se ruajtja e integritetit të euros që qarkullon në Republikën e Kosovës përbën një përgjegjësi

të rëndësishme kombëtare dhe, njëkohësisht, kontribuon drejtpërdrejt në mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit të sistemit monetar dhe financiar. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës shprehu mirënjohjen e saj ndaj Bashkimit Evropian për mbështetjen e vazhdueshme si dhe ndaj të gjitha institucioneve pjesëmarrëse për angazhimin dhe bashkëpunimin e tyre në zbatimin e kësaj nisme me rëndësi strategjike në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane.

ASK: Rritet konsumi i energjisë elektrike në maj, prodhimi i thëngjillit bie për 37 për qind

PRISHTINË, 16 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e energjisë për muajin maj 2026 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë si dhe importin dhe eksportin e

energjentëve të tjerë. Në muajin maj 2026 prodhimi bruto i energjisë elektrike nga hidrocentralet ishte 49.22 GWh që, krahasuar me maj 2025, u rrit për 51.38 %. Energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 484.02 GWh ose (-0.41 %) më e vogël krahasuar me muajin e njëjtë të

vitit paraprak, kurse konsumi i energjisë elektrike ishte 398.66 GWh ose 8.88 % më i madh krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 22.20 %. Importi i energjisë elektrike në maj të vitit 2026 ishte 422.31

GWh, kurse eksporti i energjisë elektrike në të njëjtën periudhë ishte 205.27 GWh (këtu është e përfshirë edhe sasia e transmisionit). Prodhimi i thëngjillit për muajin maj 2026 ishte rreth 301,303 mijë tonë, që paraqet një rënie prej -37.25 % krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar.



LIDERËT POPULISTË RINGRIHEN NGA HIRI I TYRE



Marine Le Pen rikthehet në lojë për zgjedhjet presidenciale franceze të vitit 2027 dhe bashkë me të kërkon një jetë të dytë, i gjithë sovranizmi europian. Gjykata që dy vjet më parë e dënoi për shpërdorim të fondeve europiane ka vepruar, me sa duket, pikërisht për të mos i dhënë Le Pen-it rolin e martires që do të favorizonte partinë e saj dhe pasardhësin, Jordan Bardella.

Por, përtej çështjes gjyqësore, vendimi nxjerr në pah dy elemente të rëndësishme. I pari është rezistenca e jashtëzakonshme e botës sovraniste, e cila ka kaluar përmes dështimeve, krizave të brendshme dhe skandaleve të mëdha pa u dëmtuar në mënyrë domethënëse në aspektin e mbështetjes elektorale. I dyti është aftësia për t'u rigjeneruar, e cila i ka shndërruar subjektet e së djathtës radikale, shpesh bartëse të propozimeve që kufizohen me narrativën antidemokratike, në forca popullore që në mënyrë të qëndrueshme luhaten mes 20

dhe 30 për qind të votave.

Nuk bëhet më fjalë për fenomene kalimtare, por për prani të qëndrueshme prej dhjetë, pesëmbëdhjetë apo njëzet vjetësh. Janë realitete me të cilat duhet të përballet politika.

Fitorja gjyqësore e Le Pen shënon ringjalljen e lideres së parë dhe më të rëndësishme nacionaliste të Bashkimit Europian, një grua që ka qenë në skenë me zgjuarsin dhe vendosmëri që prej vitit 1986, trashëgimtare e një partie krejtësisht të marginalizuar, të cilën ajo arriti ta shndërrojë në një aktor vendimtar të politikës franceze.

Për një rastësi të veçantë, po atë ditë u ringjall edhe partneri tjetër historik i sovranizmit kontinental, Nigel Farage, i rrëzuar nga një skandal financiar për pesë milionë paund të padeklaruara. Ai rrezikonte përjashtimin, por luajti në sulm: dha dorëheqjen nga Parlamenti dhe njëkohësisht njoftoi se do të kandidojë në zgjedhjet plotësuese në Clacton.

Do të jetë vota popullore, tha ai, ajo që do t'i rehabilitojë emrin dhe do t'i rikthejë të drejtën për të qenë protagonist i politikës britanike, ku Reform UK renditet vazhdimisht në krye të sondazheve.

Edhe ai është në politikë që prej vitit 1992, pra prej më shumë se tre dekadash. Ka fituar, ka humbur, është larguar nga politika, është rikthyer dhe ka ndryshuar rrënjësisht peizazhin politik të vendit të tij.

Jeta e dytë e sovranistëve europianë nis pikërisht nga këto dy histori paralele, në një mënyrë disi befasuese, po të merren parasysh goditjet që shënuan vitin 2026 për nacionalistët e rinj.

Ata u konsideruan politikisht të mbaruar kur efekti bumerang i presidencës së Donald Trumpit u përplas mbi botën perëndimore në çdo gjerësi gjeografike, duke i detyruar miqtë e vjetër të lëvizjes MAGA, Le Pen dhe Farage para së gjithash, të distancoheshin prej saj.

U konsideruan sërish të

mbaruar kur figura më e komprometuar e tyre, Viktor Orbán, i vetmi që kishte ruajtur një qëndrim hapur pro-Putinit dhe pro-Trumpit, humbi zgjedhjet në mënyrë spektakolare.

Ata u konsideruan të mbaruar edhe kur armiku i tyre kryesor, Europa, filloi të shfaqte shenja të reja vitaliteti dhe të kërkonte një strategji të përbashkët për t'u mbrojtur, për të tregtuar dhe për t'u zhvilluar.

Megjithatë, ata janë ende aty: të goditur nga skandale të mëdha dhe të mbuluar nga dyshime serioze për marrëdhënie të errëta me fuqi jashtë Europës, por gjithsesi të gjallë, energjikë dhe shumë luftarakë.


Këmbëngulja e tyre e palëkundur konfirmon barrën që ata përfaqësojnë mbi të ardhmen e Europës dhe mbi përpjekjet për të dhënë një përgjigje të përbashkët ndaj tërheqjes amerikane dhe agresionit rus në kufijtë e Bashkimit Europian.

Nëse Le Pen, prillin e ardhshëm, në përpjekjen e saj të katërt arrin ta realizojë këtë

objektiv dhe të fitojë presidencën franceze, atëherë lamtumirë koalicioni i të vullnetshmëve, lamtumirë trenave për Kiev, lamtumirë bashkëpunimit për armët, për inteligjencën artificiale, për përgjigjen ndaj krizave; lamtumirë boshtit të famshëm franko-gjerman dhe, bashkë me të, të vetmit motor që prej vitesh arrin ta shtyjë Bashkimin Europian në një drejtim të caktuar.

Nëse Farage vazhdon marshimin e tij triumfues, lamtumirë përpjekjes për afrimin mes Britanisë së Madhe dhe Europës në emër të interesave të përbashkëta në tregti dhe mbrojtje.

Dhe kështu lind një dyshim i natyrshëm, i cili po fiton gjithnjë e më shumë terren tek kushdo që dëshiron një Europë më të fortë dhe më të vetë-mjaftueshme: vallë këta janë vërtet gjeni të politikës? Apo janë kundërshtarët e tyre ata që nuk kanë qenë në lartësinë e rolit që historia u ka caktuar? Flavia Perina, La Stampa.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Federata e Volejbollit përfundon kursin për trajner "FIVB Coaches Course"

PRISHTINË, 16 KORRIK - Federata e Volejbollit e Kosovës ka përfunduar me sukses kursin për trajner "FIVB Coaches Course" - niveli i dytë, i mbështetur

nga Komiteti Olimpik i Kosovës përmes fondit të Solidaritetit Olimpik të IOC. Dhjetëra trajnerë mësuan nga përvoja dhe profesionalizmi i

instruktorit të Federatës Ndërkombëtare të Volejbollit, Kristian Michailov. Në ditën e fundit, në ambientet e "Hotel Ador" në

Prishtinë, pjesëmarrësit iu nënshtruan testit teorik, duke përmbyllur procesin e vlerësimit të njohurive të fituara gjatë kursit katërditor.



ARGJENTINA ELIMINON ANGLINË DHE KALON NË FINALEN E BOTËRORIT



PRISHTINË, 16 KORRIK - Argjentina ka realizuar një përmbyesje dramatike ndaj Anglisë në gjysmëfinalen e Kupës së Botës, duke kaluar në epërsi 2-1 në minutën e 90+2. Pasi barazoi shifrat në minutën e 85-të me Enzo Fernández, i cili shfrytëzoi një asistim të Lionel Messit dhe realizoi me një goditje të saktë nga buzë zonës, "Albicelestët" nuk u ndalën me kaq.

Në minutën e dytë shtesë Messi dhuroi edhe asistimin e dytë të mbrëmjes. Kapiteni argjentinas harkoi në mënyrë perfekte në zonë, aty ku Lautaro Martínez u shkëput nga mbrojtja angleze dhe me një goditje të lehtë me kokë e dërgoi topin në rrjetë për rezultatin 2-1. Pak sekonda para golit të fitores së përkohshme, Alexis Mac Allister kishte qenë shumë

pranë përmbyesjes, por goditja e tij e fuqishme u përplas në pjesën e jashtme të shtyllës së djathtë. Argjentina ka goditur në momentet vendimtare të sfidës dhe tani ndodhet vetëm pak minuta larg finales së madhe të Kupës së Botës. Argjentina do të përballet me Spanjën në finalen e madhe të dielën, më 19 korrik, për trofeun e Kupës së Botës.

FC MALISHEVA KUALIFIKOHET NË RAUNDIN E DYTË TË UEFA CONFERENCE LEAGUE

PRISHTINË, 16 KORRIK - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka uruar FC Malishevën për kualifikimin në raundin e dytë të UEFA Conference League pas fitores së thellë ndaj Vllaznisë së Shkodrës. Përmes një postimi në 'Facebook', FFK-ja ka vlerësuar paraqitjen e skuadrës malishevase, e cila siguroi

kalimin tutje pas triumfit 5:0 në ndeshjen e kthimit të zhvilluar në Kampin Nacional në Hajvali. Pas humbjes 2:1 në ndeshjen e parë në Shkodër, FC Malisheva reagoi fuqishëm në përballjen e dytë, duke treguar karakter, cilësi dhe shpirt gare për ta vazhduar aventurën evropiane. FFK-ja ka përgëzuar futbollistët, stafin teknik, drejtuesit e klubit

dhe tifozët për këtë sukses, duke theksuar se ky kualifikim është dëshmi e rritjes së vazhdueshme të futbollit kosovar në arenën ndërkombëtare. "Ky kualifikim është një tjetër dëshmi e rritjes së vazhdueshme të futbollit kosovar dhe një motiv shtesë për të gjitha klubet tona që garojnë në arenën evropiane", ka shkruar FFK-ja.



ASSANE DIATTA, LOJTAR I RI I PRISHTINËS



PRISHTINË, 16 KORRIK - Klubi kryeqytetas, Prishtina, ka zyrtarizuar transferimin e Assane Diattas, duke shtuar një tjetër përforcim në organikën e skuadrës për sezonin e ri. Futbollisti tashmë i është bashkuar ekipit në Bolu të Turqisë, ku bardhekaltërit po zhvillojnë fazën përgatitore nën drejtimin e stafit teknik, me synimin për të qenë gati

për sfidat që i presin në kampionat dhe në garat evropiane. Diatta vjen nga Malisheva, ku pati një edicion shumë të suksesshëm, duke realizuar 11 gola dhe shtatë asistime në 31 paraqitje në Superligën e Kosovës dhe Kupën e Kosovës. "Edhe një emër i ri i bashkohet bardhekaltërve. Assane Diatta është përforcimi më i ri i

Prishtinës, duke iu bashkuar ekipit në Bolu, aty ku skuadra po zhvillon fazën përgatitore për sezonin e ri. Diatta vjen pas një sezoni mjaft të mirë, në të cilin regjistroi 11 gola dhe 7 asistime në 31 paraqitje në kampionat dhe Kupën e Kosovës te skuadra e Malishevës. Me karakteristikat e tij sulmuese, shpejtësinë dhe aftësinë për të krijuar rrezik në repartin ofensiv, Diatta pritet

të jetë një vlerë e shtuar për ekipin në edicionin e ri. Mirë se erdhe në familjen bardhekaltër, Assane!", ka njoftuar klubi. Me profilin e tij sulmues, shpejtësinë dhe aftësinë për të kontribuar si në shënimin ashtu edhe në krijimin e rasteve, ai pritet të jetë një nga armët kryesore të Prishtinës në sezonin 2026/27.

Como pranon ofertën e rivalëve të Serisë A për Mërgim Vojvodën, gati zyrtarizimi i transferimit

PRISHTINË, 16 KORRIK - Como ka pranuar një ofertë nga Udinese për lojtarin e kombëtares së Kosovës, Mërgim Vojvoda, kështu që tani drenicasi do të diskutojë kushtet personale për ta kompletuar transferimin. Mbrojtësi i djathtë nga Kosova është 31 vjeç dhe kontrata e tij aktuale në Stadio Sinigaglia

është e vlefshme deri në qershor të vitit 2028. Ai u bashkua me Comon në shkurt të vitit 2025 nga Torino për një kosto prej 2 milionë eurosh, përpara se të luante për Standard Liege. Kishte pasur raportime për interes nga skuadra si Cagliari, Venezia dhe Monza, por duket sikur Udinese ka epërsinë për

transferimin e yllit të Kosovës. Analisti i transferimeve të Sportitalias, Gianluigi Longari, pretendon se Udinese bëri një propozim për Vojvodën dhe Como e ka pranuar. "Sky Sport Italia" jep shifrat dhe detajet duke thënë se oferta peshon 1.3 milion euro plus 300 mijë euro në bonuse. Tani është detyrë e friulanëve

të bien dakord për kushtet personale me mbrojtësin e gjithanshëm, i cili mund të luajë edhe në mbrojtje qendrore me tre, në dy krahët e mbrojtjes ose në një pozicion më të avancuar në krahun e djathtë. Vojvoda bëri 34 paraqitje për Comon sezonin e kaluar midis Serisë A dhe Coppa Italia,



duke shënuar dy gola dhe duke dhënë tre asistime.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

Bazuar në nenin 147 të Ligjit nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, aksionarët e me numër unik identifikues 811892935, me adresë në Trsenje nr.5, Brezovicë, Shtërpoë me datë , jepin këtë:

ndryshohet sa i përket kapitalit, ashtu që zvogëlohet kapitali prej ,000.00 € (njëqind e dhjetë mijë euro) në ,000.00 € (tridhjetë mijë euro).

Obligohen zyrtarët e , që këtë njoftim ta dërgojnë për publikim dy herë brenda një periudhe një javore, në të paktën një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fis Rogova nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Shani Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10,11,12,13 dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Dion Macula nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11 të gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

Saranda Karakushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1,2,3,4 dhe diplomën e SH.M. Mjekësisë në Gjakovë.

- Bajram Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën nga kl. 6-9 të sh.m.u. "Rudolf Walther" Dejnë kk Gjakovë.

- Leart Vehapi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të mjekësisë "Luciano Motroni" Prizren.

- Adizo SH.P.K. me nr. 812421460 bënë zvogëlim të kapitalit lëshuar nga ARBK.

- Jetmir Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. profesionale "Gjon Nikoll Kazazi" Gjakovë.

- Vlora I. Gashi B.I. Rogovë shpall të humbur numrin unik identifikues 811865552 lëshuar nga ARBK

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Lume's Details

Estetik & Depilim



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908